



Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015

[Deklarata të paraqitet sipas seksionit 70 (10) (a) të Mbrojtjes Ndërkombëtare, Akti 2015]

Shënim Informues - Marrëveshjet Tranzitore

Prezantimi I NJË PROCEDURE TË VETME për hetimin dhe përcaktimin e aplikimeve për Mbrojtje Ndërkombëtare (Statusi i Refugjatit dhe Mbrojtje Shtesë) dhe Leje Oëndrimi

Kjo deklaratë është vetëm për informim dhe udhëzim. Nuk përbën konsulencë ligjore dhe nuk synon të bëjë interpretim ligjor të Aktit të Mbrojtjes Ndërkombëtare, 2015. Ky Shënim trajton vetëm kategoritë kryesore të rasteve që ndikohen nga dispozitat tranzitore të Aktit të Mbrojtjes Ndërkombëtare, 2015. Nuk trajton situatat e mundshme ku mund të zbatohen dispozitat tranzitore. Nëse dëshironi më shumë informacion mbi Aktin 2015 dhe dispozitat e tij pasi zbatohen në rastin tuaj, duhet të kërkonit konsulencë ligjore.

Ky Shënim Informues duhet të lexohet bashkë me Broshurën e Informacionit për Aplikantët për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 1) dhe Pvetësorin e Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 2) të bashkëngjitur.

1. **Hyrje**
- 1.1 Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare, 2015 (Akti 2015) u vu në fuqi nga Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë ("Ministria") më **31 dhjetor 2016**. Në këtë shënim, kjo referohet si "data e fillimit".
- 1.2 Ky shënim informues ju jep detajet e marrëveshjeve tranzitore që parashkruajnë

hetimin dhe përcaktimin e aplikimeve (në disa faza të procesit) për mbrojtjen ndërkombëtare (statusi i refugjatit dhe mbrojtja shtesë) sipas Aktit të Mbrojtjes Ndërkombëtare, 2015 të kryera në Shtet (Irlandë) para datës së fillimit. Gjithashtu jep disa detaje në lidhje me lejen e qëndrimit.

1.3 Synon që t'ju ndihmojë të kuptoni marrëveshjet e zbatueshme në transferimin

- e disa aplikimeve për statusin e refugjatit dhe mbrojtjen shtesë nga Komisioneri i Zyrës së Aplikimeve si Refugjat (ORAC) dhe
- e disa apeliemeve të statusit refugjat nga Gjykata e Apelit të Refugjatit (RAT)

të cilat janë kryer para datës 31 dhjetor 2016, në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare së Shërbimit të Natyralizimit dhe Imigrimit të Irlandës për përfundimin e përpunimit sipas Aktit 2015.

1.4 Më shumë informacion i detajuar mbi bazat ku një person ka të drejtë të deklarojë statusin e refugjatit ose mbrojtje shtesë dhe procedurave për zbatim në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO) përshkruhen në Broshurën e Informacionit për Aplikantët për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 1), të bashkëngjitur. Broshura shpjegon gjithashtu edhe cilat janë të drejtat dhe detyrimet tuaja si aplikant për mbrojtje ndërkombëtare dhe me kë do të takoheni gjatë procesit të aplikimit. Broshura gjithashtu përshkruan procedurat që zbatohen për shqyrtimin e lejes së qëndrimit nga Ministri sipas nevojës së ndryshme nga ajo për mbrojtje ndërkombëtare.

1.5 Gjithashtu keni bashkëngjitur Pyetësin e Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 2).

1.6 Është e rëndësishme dhe në interesin tuaj të lexoni këtë Shënim Informues dhe Broshurën e Informacionit dhe Pyetësin me kujdes dhe të kërkonte konsulencë ligjore sipas nevojës, në mënyrë që të mund të mbështesni aplikimin tuaj dhe të **siguroheni se i kuptoni si zbatohen për ju marrëveshjet tranzitore të Aktit 2015.**

2. **Qëllimi i Aktit 2015 të Mbrojtjes Ndërkombëtare**

2.1 Akti 2015 parashikon përdorimin e një procedure të vetme për aplikimin e cila

mundëson të gjitha arsyet për kërkimin e mbrojtjes ndërkombëtare (statusi i refugjatit dhe mbrojtja shtesë) dhe lejen për të qëndruar në Shtet për arsye të tjera që do të shqyrtohen dhe përcaktohen në proceset vijuese.

- 2.2 Akti 2015 përmban marrëveshjet tranzitore që zbatohen për disa aplikime për statusin e refugjatit dhe mbrojtjen shtesë të cilat janë bërë para datës së fillimit (**shikoni seksionin 4**).

3. Kush do të përcaktojë aplikimet dhe apelimet sipas Aktit 2015?

- 3.1 Sipas Aktit 2015, ORAC shfuqizohet. Përgjegjësia për hetimin dhe përcaktimin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare dhe çështjet e lidhura të lejeve të qëndrimit që mbulohen nga ky Shënim Informues, që nga data e fillimit duke iu nënshtuar dispozitave të aktit 2015, është transferuar te Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO) të Shërbimit të Natyralizimit dhe Imigrimit të Irlandës (INIS).
- 3.2 Sipas Aktit 2015, gjithashtu edhe RAT shfuqizohet. Përgjegjësia për përcaktimin e apelit në lidhje me zbatimet për mbrojtje ndërkombëtare që nga data e fillimit duke iu nënshtuar dispozitave të Aktit 2015 është transferuar te Gjykata e Apelit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPAT).

4. Marrëveshjet tranzitore për aplikimet ekzistuese për statusin e refugjatit dhe mbrojtjen shtesë që nuk janë finalizuar para datës së fillimit

- 4.1 Nëse aplikimi nuk i nënshtrohet Rregullores së BE Dublin, në të cilën zbatohen marrëveshjet të tjera (shikoni seksionin 10 të Broshurës së Informacionit për Aplikantët për Mbrojtje Ndërkombëtare), marrëveshjet vijuese tranzitore do të zbatohen për statusin e refugjatit dhe mbrojtjen shtesë të bëra para datës së fillimit dhe të cilat nuk janë finalizuar deri në atë datë.

Kategoria 1 - Aplikimet për refugjat në ORAC

Nëse keni aplikuar për status refugjati para datës së fillimit por nga ORAC nuk është përgatitur një raport sipas seksionit 13 të Aktit të Refugjatit, 1996 deri në atë datë (me fjalë të tjera, nuk është bërë rekomandimi), aplikimi juaj do të quhet se është aplikim për mbrojtje ndërkombëtare (si për status refugjati edhe për mbrojtje shtesë)

sipas Aktit 2015. Dosja juaj është transferuar te Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare për shqyrtim nëse keni të drejtë për status refugjati ose deklaratë për mbrojtje shtesë.

Nëse përcaktoheni se nuk keni të drejtë për status refugjati ose mbrojtje shtesë, Ministri do të shqyrtojë menjëherë nëse do t'ju jepet leje qëndrimi për arsye të tjera. Ky vendim bazohet sipas dokumenteve që keni dërguar tashmë dhe nuk ju kërkohet të bëni aplikim të ri për leje qëndrimi.

Kategoria 2 - Apelimet e refugjatëve

Nëse aplikimi juaj për statusin e refugjatit ishte në apel te RAT para datës së fillimit por nuk ishte vendosur nga RAT deri në atë datë, ju do të quheni se keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare sipas Aktit 2015. Dosja juaj është transferuar te IPO për shqyrtim të së drejtës tuaj vetëm për mbrojtje shtesë. Në këto raste, rekomandimi mbi aplikimin tuaj për status refugjati i bërë nga ORAC do të ruhet dhe mbetet. Nëse IPO rekomandon se nuk do të merrni mbrojtje shtesë, Ministri do të shqyrtojë menjëherë nëse do t'ju jepet leje qëndrimi për arsye të tjera. Apeli i mëparshëm te RAT do të ruhet dhe transferohet te IPAT i ri. Nëse juve ju refuzohet mbrojtja shtesë, gjithashtu mund të apeloni rekomandimin për mbrojtje shtesë nga IPO te IPAT dhe të dy apelimet do të trajtohen si një dhe dëgohen bashkë. Nëse gjithashtu ju refuzohet leja e qëndrimit nga IPO duhet të keni parasysh se sipas Aktit 2015 nuk mund të apeloni për lejen e qëndrimit tek IPAT-i.

Kategoria 3 - Mbrojtja shtesë

Nëse keni aplikuar për mbrojtje shtesë para datës së fillimit dhe ORAC nuk e ka filluar hetimin deri në atë datë, aplikimi juaj do të quhet se është aplikim për mbrojtje ndërkombëtare sipas Aktit 2015. Dosja juaj është transferuar te IPO për shqyrtim vetëm për çështjen e mbrojtjes shtesë. Në këtë rast rekomandimi mbi aplikimin tuaj për statusin e refugjatit të kryer nga ORAC (ose vendimi për RAT mbi apelin, nëse zbatohet) do të ruhet dhe qëndrojë në fuqi.

Informacion shtesë

- (i) Nëse keni aplikuar për mbrojtje shtesë para datës së fillimit dhe ORAC ka filluar shqyrtimin e aplikimit deri në atë datë, aplikimi nuk ndikohet nga Akti 2015, përveç faktit se IPO merr përsipër funksionet e ORAC. Legjislacioni para-ekzistues vazhdon të zbatohet dhe IPO do të shqyrtojë aplikimin tuaj sipas procedurave të vjetra.

- (ii) Nëse keni bërë aplikim për mbrojtje shtesë dhe ky aplikim është në proces apelimi te RAT para datës së fillimit, apelimi do të transferohet te IPAT, i cili do të vendosë sipas ligjit para-ekzistues.

5. Leja e qëndrimit

- 5.1 Nëse IPO rekomandon që aplikimi tuaj për mbrojtje ndërkombëtare sipas Aktit 2015 të refuzohet (qoftë për statusin e refugjatit dhe mbrojtjen shtesë apo vetëm për mbrojtjen shtesë), vendimi do të merret nëse do t'ju jepet leje qëndrimi në Shtet ose për arsye tjetër.

- 5.2 Është e rëndësishme të vihet re se procedurat kanë ndryshuar ku Akti 2015 zbatohet deri kur Ministri nuk ju shkruan më duke ju ftuar për të bërë paraqitje në lidhje me arsyen përse duhet të merrni leje qëndrimi në Shtet. Në vend të kësaj, do të shqyrtohet nga IPO nëse rekomandohet refuzimi për mbrojtje ndërkombëtare. Vendimi do të merret në bazë të informacionit dhe dokumenteve të paraqitura në çështjen tuaj.

- 5.3 Për këtë arsye, nëse çështja juaj është transferuar te IPO për shqyrtim sipas Aktit 2015 duhet të vendosni me shkrim arsyet përse mendoni se duhet të merrni leje qëndrimi në pjesën përkatëse të Pyetësorit të Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 2). Për shembull, familja dhe rrethanat familjare tuaja, natyra e lidhjes tuaj me Shtetin, karakteri dhe sjellja juaj si brenda edhe

jashtë Shtetit dhe vlerësimet humanitare janë të gjitha çështje mundësisht të rëndësishme. Për një shpjegim të plotë të çështjeve përkatëse, ju lutemi të lexoni Broshurën e Informacionit për Aplikantët për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 1).

5.4 Gjithashtu duhet të mbani IPO-n (në emër të Ministrit) të informuar për çdo ndryshim në rrethanat tuaja që mund të jenë të rëndësishme (p.sh. për familjen ose rrethanat familjare apo për gjendjen në vendin tuaj të origjinës).

6. Nëse përfshihem nga marrëveshjet tranzitore a duhet të bëj aplikim tjetër për mbrojtje ndërkombëtare?

Nëse aplikimi juaj për mbrojtje ndërkombëtare është ndërmjet kategorive të përmendura në seksionin 4 më sipër, **nuk** keni nevojë të bëni aplikim të ri për mbrojtje ndërkombëtare te Ministri por duhet të ndiqni udhëzime në seksionin 7 më poshtë në lidhje me plotësimin e pjesëve përkatëse të Pyetësorit të Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 2).

7. Plotësimi i Pyetësorit të Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare

7.1 Nëse aplikimi juaj përcaktohet se është aplikim për mbrojtje ndërkombëtare në Kategoritë 1, 2 ose 3 të paracaktuara në seksionin 4 më sipër duhet të plotësoni Pyetësorin e Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare si vijon:

Çështjet e Kategorisë 1 (status refugjati, mbrojtje shtesë dhe leje qëndrimi)

Ju lutemi të plotësoni **të gjithë** Pyetësorin.

Çështjet e Kategorisë 2 (mbrojtje shtesë dhe leje qëndrimi)

Ju lutemi të plotësoni Pyetësorin por të mos plotësoni seksionin që lidhet me statusin e refugjatit (**Pyetjet 63a dhe 63b**).

Çështjet e Kategorisë 3 (mbrojtje shtesë dhe leje qëndrimi)

Ju lutemi të plotësoni Pyetësorin por të mos plotësoni seksionin që lidhet me statusin e refugjatit (**Pyetjet 63a dhe 63b**).

7.2 Gjithashtu ju duhet të jepni informacion shtesë me shkrim për të mbështetur aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare që mendoni se është i nevojshëm. Nuk keni përse të ridërgoni dokumentet e dërguara tashmë në lidhje me aplikimin tuaj, pasi të gjitha ato mbeten në dosjen tuaj.

7.3 Duhet të ktheni PyetëSORIN e Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 2) bashkë me informacionin shtesë të cilin po e paraqisni në mbështetje të aplikimit tuaj për mbrojtje ndërkombëtare dhe për leje qëndrimi (nëse keni), nëse është e mundur, jo më vonë se 20 ditë pune nga data e letrës së kërkesës që keni marrë bashkë me këtë Shënim Informues në zarfin FREEPOST të bashkëngjitur në

**Transitional Cases Section,
International Protection Office,
Irish Naturalisation and Immigration Service,
79 - 83 Lower Mount Street,
Dublin 2,
D02 ND99**

7.4 **Nëse ju dhe/ose konsulenti juaj ligjor duhet të jepni informacion shtesë te IPO pasi të keni dërguar informacionin e paragrafit 7.3 më sipër, duhet ta bëni sa më shpejt që të jetë e mundur dhe nëse mund ta bëni, jo më vonë se dy javë para datës së intervistës tuaj të programuar. Kjo renditje kohore lehtëson përkthimin e dokumenteve nëse nevojitet dhe garanton se intervistuesi i IPO-s të disponojë dokumentet dhe t'i shqyrtojë paraprakisht datës së intervistës.**

8. Kur do të intervistohem sipas Aktit të Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015?

8.1 Pasi të keni plotësuar dhe kthyer PyetëSORIN e Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 2) dhe çdo informacioni plotësues shoqërues me seksionin 7, Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare do t'ju kontaktojë në vazhdim rreth caktimit të intervistës tuaj, nëse nevojitet. Intervista juaj mund të mos planifikohet për disa muaj për shkak të numrit të madh të aplikimeve që janë për shqyrtim nga IPO.

8.2 Nuk ka nevojë që të kontaktoni direkt ose indirekt Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare për të kërkuar intervistë.

9. Kur do të dëgjohet apelimi im nga IPAT?

9.1 Nëse keni apelim në pritje të statusit të refugjatit që nuk është vendosur para datës së fillimit, dosja juaj do të transferohet te IPO sipas paracaktimit në seksionin 4 më sipër.

9.2 Nëse keni apelim për mbrojtje shtesë në pritje, kjo do të dëgjohet nga IPAT dhe do të informoheni për datën e dëgjimit nga IPAT.

10. Informacion shtesë

10.1 Çdo pyetje në lidhje me përmbajtjen e këtij Shënimi Informues duhet të dërgohet **me shkrim** te Customer Service Centre, International Protection Office, Irish Naturalisation and Immigration Service, 79-83 Lower Mount Street, Dublin 2 ose te adresa **info@ipo.gov.ie**

10.2 Akti Ndërkombëtar i Mbrojtjes 2015 dhe mjetet shoqëruese statutore mund të shikohen plotësisht në adresën **www.ipo.gov.ie**

10.3 Ky Shënim Informues gjithashtu disponohet në shumë gjuhë tek adresa e mësipërme.

10.4 Mund të përfitoni nga shërbimet e Bordit të Asistencës Ligjore me aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare ose leje qëndrimi. Në të kundërt mund të konsultoheni me një avokat privat me shpenzimet tuaja.

10.5 Këtu keni të drejtë të konsultoheni me Komisionerin e Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara në lidhje me aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.

10.6 Detajet e Kontaktit për organizatat e përmendura në këtë Shënim Informues gjenden në **Shtojcën 1**.

**Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare
Shërbimi i Emigracionit dhe Natyralizimit i Irlandës**

Janar 2017

SHTOJCA 1
DISA DETAJE KONTAKTI

International Protection Office

Irish Naturalisation and Immigration Service
79-83 Lower Mount Street,
Dublin 2. D02 ND99
Telefon: 01 6028000
Fax: 01 602 8122
Faqja në internet: www.ipo.gov.ie
Email: info@ipo.gov.ie

International Protection Appeals Tribunal

6/7 Hanover Street,
Dublin 2. D02 W320
Telefon: 01 474 8400
Lo-Call: 1890 210 458
Fax: 01 474 8410
Faqja në internet: www.protectionappeals.ie
Email: info@protectionappeals.ie

Legal Aid Board

Legal Aid Board Law Centre - Smithfield,
48/49 North Brunswick Street,
Georges Lane,
Dublin 7. D07 PE0C
Telefon: 01 646 9600.
Faqja në internet: www.legalaidboard.ie
Email: lawcentresmithfield@legalaidboard.ie

International Organisation for Migration.

116 Lower Baggot Street,
Dublin 2. D02 R252
Telefon falas: 1800 406 406
Telefon: +353 1 676 0655
Faqja në internet: www.ireland.iom.int
Email: iomdublin@iom.int

United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR)

102 Pembroke Road,
Ballsbridge,
Dublin 4. D04 E7N6
Telefon: 01 6314510
Email: iredu@unhcr.org